



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 21.3.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Sevdije Lama, Hetem Arifi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Ministri i MMPH dhe sekretari i MBPZHR, zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 14.3.2011.**
- 3. Shqyrtimi i projekt Buxhetit të Kosovës lidhur me Mjedisin dhe Bujqësinë.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 14.3.2011

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa ndonjë vërejtje. **Daut Haradinaj** pyeti **Liburn Aliun** a pajtohet të qëndroj konstatimi i tij nga mbledhja e kaluar sa i përket OSCE, i cili pohoi sërish atë qëndrim (neutraliteti i OSCE-së ndaj Kosovës).

3. Shqyrtimi i projekt Buxhetit të Kosovës lidhur me Mjedisin dhe Bujqësinë

Në fillim **Nait Hasani** falënderoj përfaqësuesit e dy ministrive për prezencë, me çka tregohet se janë të gatshëm për bashkëpunim në të ardhmen. Ai fillimisht njoftoj se ky komision është njoftuar për një plan strategjik nga të dy ministrinë për vitin 2011 mirëpo ende jo i zyrtarizuar, ndaj kërkoi bashkëpunim të mëtejshëm në mënyrë që komisioni me dy ministrinë të kanë qasje të përbashkët dhe të suksesshëm ndaj sfidave që presin bujqësinë dhe mjedisin. Në vazhdim kërkoi në emër të komisionit të dëgjohen përfaqësuesi i MMPH dhe MBPZHR

lidhur me buxhetin e vitit 2011 në mënyrë që pas debatit komisioni të saktësohet për rekomandim eventual.

Dardan Gashi –ministër i MMPH konstatoi se projekt buxheti i sivjem është i harmonizuar me ministrinë e financave dhe është i përcjellur nga ish ministri pa pasur mundësi që të bëhen ndryshime serioze sa i përket investimeve dmth nuk ka ndonjë fond të ri. Momentalisht negociohen disa projekte me disa organizata, sidomos ato për lumenjtë e Kosovës, të cilat fillimisht duhet të planifikohen mirë, ngase këtu fjalën e kanë edhe komunat. Fshati Hade, më në fund do të lirohet nga kjo ministri me një shumë prej 400.000 euro (edhe 320.000 tjera) me të cilat parashihet përfundimi i transferimit të banorëve në një vend tjetër. Rolin kryesorë do të ketë KEK-u. Ai përfundoi se në këtë ministri është një disponim pozitiv sa i përket buxhetit ngase është funksionale, ndërsa për projekte kapitale duhet të gjenden donatorët.

Sekretari i MBPZHR Kapllan Halimi u.d. paraqiti ngjashëm pasqyrën e buxhetit të sivjetshëm në këtë ministri me një rritje prej 2.7 milion euro por edhe me një besim të plotë se do të ketë trende pozitive. Komiteti i donatorëve gjithashtu janë të interesuar për çka besohet për suksese të mëtejme.

Pyetja e parë ishte nga **Afërdita Berisha** e cila pyeti çka mundet MMPH të veproj me 400.000 euro sa i përket fshatit Hade, ndërsa ministri u përgjigj se me këtë shumë dhe 300.000 euro ekstra shtesë tjera do të rregullohen çështjet e mbetura, ngase KEK dhe Komuna (lidhur me urbanizim etj) janë kryesorët në këtë drejtim sa i përket këtyre banorëve.

Daut Haradinaj pyeti për vreshtarët e Rahovecit sa janë paguar, për çka sekretari njoftoi se pjesa e dytë e pagesave do të bëhet posa të miratohet buxheti (pjesa e parë prej 700.000 euro janë paguar). Pastaj vazhdoi me pyetjen rreth lejeve në Deçan në zonat e mbrojtura ku dëmtohen vazhdimisht pyjet por askush nuk kujdeset për shkak të vijës së demarkacionit me Malin e zi, për çka ministri nuk kishte njohuri të mjaftueshme, ndërkaq për ndarjen e ujërave kufitare në Rugovë, ministri tha se organet kompetente duhet të veprojnë në këtë drejtim bashkërisht me ato të Malit të Zi. Mirëpo z. Haradinaj insistoi të informohet më tepër ngase aty janë duke ndodhur ndërtimet e vazhdueshme që mund të sjellin tek problemet e ndryshme. Për këtë ministri kërkoi nga i njëjti të dërgoj informatën me një shkresë MMPH-së. Sa i përket shkatërrimit të lumenjve dhe shtretërve të tyre, ministri tha se këtu nuk vepron vetëm MMPH ngase komunat i japin lejet.

Salih Morina konstatoi se 2.7 % ka rritje në MBPZHR, ndërkaq sa është ajo në MMPH, përgjigja ishte se ajo ka një ramje të vogël, por meqë fshati Hade do të hiqet nga obligimi i MMPH deri në qershor 2011 parashihet një lehtësim për këtë ministri. Pyetja e radhës ishte sa i përket ndotjes së rajoneve të caktuara (Malishevë-fshati Ostrazub) me “pluhur të bardhë” nga separacionet e ndryshme, ministri u përgjigj se nuk është gabimi i MMPH që jap licenca por në pyetje është si shfrytëzohet ajo, ngase lejet epen nga komuna. Pyetja tjetër ju drejtua MBPZHR për vreshtarët, ngase a planifikon kjo ministri të kryej këtë problem vetëm me këtë lloj të pagesave apo edhe më afatgjatë mendohet. Sekretari tha se mbasdite do ti dërgoj informacionet shtesë me shkrim për komisionin, ngase patjetër që ministria mendon për një periudhë më të gjatë (edhe **Daut Haradinaj** u bashkëngjiti për këtë pyetje).

Liburn Aliu insistoi se ky buxhet është tejet i vogël dhe komplet në kundërshtim me idenë apo synimin e zhvillimit të vendit, me pretendim të rritjes vetëm me 1.02 %, ngase bujqësia është elementi dhe prioriteti kryesorë për zhvillimin e Kosovës, ndërkaq gjithashtu sa i përket edhe mjedisit, Kosova paraqet pikën e zezë në Ballkan me çka asnjëherë nuk do të siguroj integritet e mëtejme sa i përket jetës cilësore, ai mori shembull shkatërrimin sistematik dhe gradual të pylltarisë në Kosovë, sa që ajo asnjëherë nuk do të mund të riparohet, kjo për arsye sepse Qeveria ndërton rrugë ndërkaq në anën tjetër bujqësia shkatërrohet.

Sevdije Lama pyeti për plane urbanistike, për çka ministri tha se shpejt ato do të publikohen dhe do të ekzekutohen, gjithashtu ajo pyeti edhe për planin e pastrimit të lumenjve sa do të janë të realizueshme. Ministri konstatoi se ato vazhdimisht bëhen por në anën tjetër vazhdimisht edhe shkatërrohen për çka duhet të jap përgjegjësi edhe komuna.

Sekretari i MBPZHR ndërhyri për çështjet e iniciuara nga **Liburn Aliu** duke konstatuar se ministria ka ndërmarr një hap të përbashkët me donator siç janë komisioni evropian, banka botërore, Danimarka etj shuma të cilat do ti bashkëngjiten buxhetit të ministrisë. Gjithashtu ai potencoi faktin se kontrollet tek fermerët do të rriten, ngase vetëm nga kjo veprimtari p.sh. ka pas përfitim ministria 300.000 euro, dmth në radhë të parë do të kemi edukimin e fermerëve. **Liburn Aliu** kërkoi që të saktësohet si do të konkretizohet kjo që po tregon sekretari, i cili tha se kjo do të bëhet me një kërkesë shtesë prej 25 milion euro. **Ministri Dardan Gashi** u bashkëngjiti bisedës duke theksuar se edhe në MMPH do të ketë rritje progresive. Në pyetjen e **Salih Morinës**, sekretari i bujqësisë tha se kërkesat për vitin 2011 kanë qenë racionale prej 17 milion euro.

Nijazi Idrizi ngriti problemin e çmimit të bukës, grurit, bllokadës nga ana e Sërbisë me eksport të grurit dmth si të veprohet në këtë drejtim, për çka sekretari tha se ministria është në fazën e diskutimeve për subvencionim etj, ndërsa në anën tjetër 43.000 ha janë të mbjellur me grurë. Gjithashtu i njëjti pyeti ministrin e mjedisit se a ka dijeni për themelimin e një bordi rreth menaxhimit me pyje për shkak të konfliktit me pyje. Ministri tha se nuk është i informuar rreth problemit në fjalë por me siguri do të insistohet të rregullohet problemi në nenin përkatës rreth zonave të mbrojtura. Edhe sekretari nga ministria e bujqësisë premtoi se ky problem do të diskutohet me zyrtarët e MMPH para se të hartohet ligji për pyje, i cili është në finalizim e sipër.

Kryetari Nait Hasani njoftoi të pranishmit se komisioni do të kërkoj zbatimin e Ligjit për rezervat shtetërore gjithnjë duke pasur parasysh problemit e importit dhe eksportit të grurit, ndërkaq për një periudhë jo aq të gjatë komisioni parasheh monitorimin e ligjit për tokat bujqësore dhe asaj të VNM pasi që edhe në këtë mbledhje kishte interesim të anëtarëve të komisionit rreth lejeve të ndryshme (gurthyes, “pluhuri i bardhë” etj) nëpër fushat e Kosovës. Pasi që zyrtarët e dy ministrive u larguan, kryetari sugjeroi që komisioni ti dërgoj komisionit funksional për buxhet përfundimin si vijon :

R E K O M A N D I M

Duke pasur parasysh që Bujqësia dhe Mjedisi në Kosovë duhet të shpallen prioritet për zhvillimin e mëtejshëm, kërkohet nga komisioni parlamentar dhe funksional për Buxhet duke amenduar projektligjin për Buxhetin e vitit 2011, të hartoj kërkesën zyrtare për rritjen e buxhetit të Ministrisë së Mjedisit dhe të Bujqësisë për investime kapitale, ose së paku të rishikohet ky buxhet pas 6 muajve për të rritur buxhetin e dy ministrive në fjalë.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani inicioi një vizitë dyditore fillimisht në Shqipëri në pjesën e parë të prillit të këtij viti, ku do të diskutohen me homologët pyetjet dhe problemet e përbashkëta në fushën e komisionit, për çka komisioni u pajtua. Ai tha se vizita do të bëhet me automjetet e Kuvendit, ndërsa shpenzimet e qëndrimit do të kërkohen nga nikoqirët. Koordinatorin u obligua të kontaktoj me ambasadën e Shqipërisë dhe të njoftoj për temat që do të diskutohen atje me këtë vizitë.

Lidhur me **ofrimin e ekspertëve nga NDI** për këtë komision, kryetari sugjeroi që në një takim të prezantoi zyrtari i caktuar për këtë ofertë për çka do të deklarohet edhe komisioni, pastaj do të dërgohet kërkesa në emër të komisionit për këtë shërbim. Për shkak se organizata e NDI ka marrëveshje për bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, nuk do të ketë nevojë për marrëveshje të veçantë me këtë komision lidhur me këtë, do të mjafton vetëm kërkesa e komisionit për ndihmë me ekspertë (sqarim nga stafi).

Komisioni do të njoftohet lidhur me veprimet e mëtejme të komisionit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,05.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

